

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT**



PUNIM I DIPLOMËS - MASTER

**NDIKIMI I DISA PARAMETRAVE TË LOJËS SË FUTBOLLIT NË
REZULTATIN FINAL TË KF „BALLKANI” NË DY PERIUDHA
KOHORE 2023 DHE 2024 NË ARENËN NDËRKOMBËTARE.**

Mentori:

Prof. Ass. Dr. Malsor Gjonbalaj

Kandidati:

Besart Berisha

Prishtinë, 2025

**UNIVERSITY OF PRISHTINA “HASAN PRISHTINA”
FACULTY OF PHYSICAL EDUCATION AND SPORTS**



DIPLOMA THESIS - MASTER

**THE IMPACT OF SELECTED FOOTBALL GAME PARAMETERS
ON THE FINAL RESULTS OF FC “BALLKANI” IN TWO TIME
PERIODS 2023 AND 2024 IN INTERNATIONAL COMPETITIONS**

Mentor:

Prof. Ass. Dr. Malsor Gjonbalaj

Candidate:

Besart Berisha

Prishtina, 2025

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT**



PUNIM I DIPLOMËS – MASTER

Lënda: Futboll

Titulli i punimit: Ndikimi i disa parametrave të lojës së futbollit në rezultatin final të KF „Ballkani” në dy periudha kohore 2023 dhe 2024 në arenën ndërkombëtare.

Emri dhe Mbiemri: Besart Berisha

Status i studentit: I rregullt

Numri i amzës (ID Regjistri):

Shkalla e studimit: Master

Drejtimi:

Mentori: Prof. Ass. Dr. Malsor Gjonbalaj

Prishtinë, 2025

DEKLARATË MBI ORIGJINALITETIN E PUNIMIT

Me anë të kësaj deklarate, unë Besart Berisha deklaroj me përgjegjësi të plotë se ky punim me titull “Ndikimi i disa parametrave të lojës së futbollit në rezultatin final të KF „Ballkanit” në dy periudha kohore 2023 dhe 2024 në arenën ndërkombëtare”, është punim autorial i imi. Punimi i paraqitur këtu është origjinal dhe është kryer personalisht nga unë dhe respekton të gjitha kërkesat për të drejtat e autorit, duke saktësuar dhe cituar të gjitha kontributet nga burimet e tjera.

Emri e mbiemri

Nënshkrimi

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	10
2. HULUMTIMET E DERITANISHME	14
3. QËLLIMI I PUNIMIT	19
3.1 HIPOTEZAT THEMELORE.....	19
4. METODAT E HULUMTIMIT	21
4.1 Mostra e entitetit.....	21
4.2 Variablat që jan aplikuar	21
4.3 Mënyra e zbatimit të hulumtimit.....	22
5. METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE	25
6 INTERPRETIMI I REZULTATEVE.....	26
6.1 Analiza deskriptive e ndryshoreve të KF”Ballkani” të vitit 2022 në ndeshjet ndërkombëtare.....	26
6.2 Analiza deskriptive e ndryshoreve të kundërshtarëve të KF ”Ballkani” të vitit 2022 në ndeshjet ndërkombëtare.....	28
6.3 Analiza deskriptive e ndryshoreve të KF ”Ballkani” të vitit 2023 në ndeshjet ndërkombëtare.....	30
6.4 Analiza deskriptive e ndryshoreve të kundërshtarëve të KF ”Ballkani” të vitit 2023 në ndeshjet ndërkombëtare.....	32
6.5 Korelacionet ndërmjet ndryshoreve të KF ”Ballkani” dhe të kundërshtarëve të tij të vitit 2022.....	34
6.6 korelacionet ndërmjet ndryshoreve të KF ”Ballkani” dhe të kundërshtarëve të tij të vitit 2023.....	37

6.7	T – testi ndërmjet rezultateve të KF :Ballkani” 2023 dhe rezultateve të KF “Ballkani” 2022.....	39
6.8	T-testi i ndryshores përqindja e posedimit të topit ndërmjet ekipeve fituese dhe atyre humbëse ndërmjet KF “Ballkani” dhe kundërshtarëve të tij në arenën ndërkombëtare për vitin 2022 dhe 2023.	41
6.9	T-testi i ndryshores shutat në kornizë të portës ndërmjet ekipeve fituese dhe atyre humbëse ndërmjet KF “Ballkani” dhe kundërshtarëve të tij në arenën ndërkombëtare për vitin 2022 dhe 2023.	42
6.10	T-testi i ndryshores përqindja e posedimit të topit ndërmjet ndeshjeve të fituara të KF “Ballkani” dhe ndeshjeve të humbura të KF “Ballkani” në arenën ndërkombëtare për vitin 2022 dhe 2023.	43
6.11	Analiza regresive.....	44
	Regresioni i ndryshores rezultati i ndeshjes	44
7	ANALIZA DHE VËRTETIMI I HIPOTEZAVE	46
8	RËNDËSIA TEORIKE DHE PRAKTIKE E PUNIMIT	47
9	LITERATURA.....	50

FALENDERIME

Për realizmin e punimit me temën “Ndikimi i disa parametrave të lojës së futbollit në rezultatin final të KF „Ballkani” në dy periudha kohore 2023 dhe 2024 në arenën ndërkombëtare”, kam pasur mbështetjen e disa personave të cilët ndjej obligim që ti falënderoj.

Në radhë të parë dëshiroj ta falënderoj familjen time që më kuptuan, më mbështetën dhe më përkrahën në çdo aspekt deri në realizmin final të punimit të magjistraturës, ky punim nuk do të mund të realizohej me sukses pa ndihmën morale, motivuese, dhe nxitëse të tyre.

Në mënyrë të veçantë dëshiroj ta falënderoj mentorin e këtij punimi Prof. Ass. Dr. Malsor Gjonbalaj i cili pa rreshtur më përkrahu, më mbështeti, më udhëzoi, mbi të gjitha besoi në mua, deri në relizimin përfundimtar të këtij punimi.

Gjithashtu falënderoj stafin udhëheqës të KF “Ballkani” për mirëkuptimin, mbështetjen e dhënë, ndihmën në mbledhjen e të dhënave dhe konfirmimin e ekzaktësisë së tyre.

ABSTRAKT

Në këtë punim janë marr për analizim 14 ndeshje të KF “Ballkani” të luajtura në arenën ndërkombëtare në vitin 2022 dhe 14 ndeshje të KF “Ballkani” të luajtura në arenën ndërkombëtare në vitin 2023. Qëllimi i punimit është që të gjendet dhe vërtetohen arrëdhënjet në mes të dhe disa parametrave të lojës së futbollit dhe rezultatet e ndeshjeve të zhvilluara.

Në punim janë përfshirë 9 ndryshore. Bazuar në qëllimin e punimit janë përdorur këto metoda statistikore: parametrat themelor statistikor, korelacionet sipas Pearsonit, T-testi dhe analiza regressive.

Pas analizimit të rezultateve të përpunuara është mundësuar vërtetimi i hipotezave të parashtruara:

H1. Pritet që nga ndeshjet që ka luajtur KF”Ballkani” në arenën ndërkombëtare në vitet 2022 dhe 2023 në të cilat ka pasur më shumë kohë në posedim të topit ka shënuar fitore. Është vërtetuar pjesërisht; H2. Pritet që nga të gjitha ndeshjet e zhvilluara të KF”Ballkani” dhe kundërshtarëve të tij në arenën ndërkombëtare në vitet 2022 dhe 2023, ekipet që kanë fituar kanë pasur posedim të topit në përqindje më të lartë. Është vërtetuar në tërësi; H3. Pritet që nga ndeshjet që ka luajtur KF”Ballkani” në arenën ndërkombëtare në vitet 2022 dhe 2023 në të cilat ekipet që kanë pasur më shumë shuta në kornizë të portës kanë shënuar fitore. Është vërtetuar në tërësi; H4. Pritet që nga ndeshjet që ka luajtur KF”Ballkani” në arenën ndërkombëtare në vitin 2023 të ketë treguar performancë më të mirë se sa në ndeshjet e zhvilluara në arenën ndërkombëtare në vitin 2022. Nuk është vërtetuar.

Ky punim ofron të dhëna të qarta për relacionin e ngusht ndërmjet disa karakteristikave të lojës së futbollit dhe rezultatit të ndeshjes, gjithashtu ky studim tregon për rëndësinë që ka posedimi i topit në lojën e futbollit. Vlen të theksojmë se loja e futbollit është shumë komplekse dhe se parashikimi i rezultatit të ndeshjes ende mbetet mister i pazgjidhur përkundër hulumtimeve të shumëta an e mban botës.

Fjalët kyçe: ndikim, parametra, lojë, futboll, rezultat, arenë ndërkombëtare, KF “Ballkani”.

ABSTRACT

This study examines 14 international matches played by FC “Ballkani” in 2022 and 14 in 2023. The primary objective is to identify and validate the relationships between specific football performance parameters and match outcomes. Nine variables were analyzed using statistical methods including basic descriptive statistics, Pearson correlations, T-tests, and regression analysis.

The findings support the following hypotheses: H1. FC “Ballkani” was expected to secure victories in international matches during 2022 and 2023 when it maintained higher ball possession. This was partially confirmed. H2. Across all international matches involving FC “Ballkani” and their opponents in 2022 and 2023, it was expected that winning teams would exhibit higher ball possession percentages. This was fully confirmed. H3. It was anticipated that in FC “Ballkani’s” international matches in 2022 and 2023, teams with more shots on target would win. This was fully confirmed. H4. It was hypothesized that FC “Ballkani” would demonstrate superior performance in 2023 compared to 2022. This was not confirmed.

This research underscores the close association between certain match parameters—particularly ball possession—and game outcomes, while also highlighting the inherent complexity of football, where predicting results remains an unresolved challenge despite extensive global research.

Key words: influence, parameters, football, match outcome, international competitions, FC “Ballkani”.

1. HYRJE

Futbolli është disiplinë me një teknikë të pasur me topin, që përveç duarve, mund të luhet me të gjitha pjesët tjera të trupit duke bërë që të jetë njëri prej disiplinave sportive më interesante dhe duke ndikuar që miliona shiques në mbar botën t'i kushtojn vëmendje e mbi të gjitha emocion të jashtzakonshëm. Në të njëjtën kohë futbolli është një fenomen global. Futbolli mund të luhet në mënyrë profesionale, amatore, rekreative ose si pjesë e aktivitetit shkollor. Futbolli është një lojë që luhet pavarësisht nga mosha, gjinia, raca, feja. Si disiplinë sportive futbolli përkufizohet si një sport kolektiv, përkatësisht sport ekipor që i takon sporteve olimpike.

Fillet e futbollit datojnë nga historia e largët mijëvjeçare, ku me objekte të rrumbullakëta të bëra nga materiale të ndryshme, janë përdorur në mënyrë të ngjashme si futbolli i sotshëm. Lojërat me topin, me karakteristika të futbollit, së pari u shfaqën në Kinë në vitin 3000 para p.e.s. Loja u quajt cu-ki (cu-shtytje, ki-top), themelues i kësaj loje ishte Huan Ti. Qëllimi fillestar ishte larg nga ai që ka sot, kishte karakter të luftës, pasi Juan Ti mendonte se ushtarët e tij do të forcohen me këtë lojë. Është luajtur me top të mbushur me pupla dhe lesh të kafshëve dhe loja konsistonte në faktin se dy ekipet, të vendosura përballë njëri-tjetrit, përpiqeshin për të shtryrë topin mes dy bambuve të cilat simbolizonin golat. Fituesi ishte ai që i pari e fuste topin ndërmjet kallamëve të bambusit. Në lojë kanë marrë pjesë një numër i madh i lojtarëve, numri i të cilëve nuk është precizuar saktësisht.

Shumë më vonë, rreth vitit 600 p.e.s, kjo lojë fillon të luhet me top të mbushur me ajër. Në atë kohë, kjo lojë (cu-ki) kalon në Japoni me emrin "Kemari". Futbolli ka rrënjët e saj edhe në Greqinë e lashtë, ku gjithashtu përmendet një lojë e ngjashme, me emrin "episkyros". (Shiljak, 2007).

Të gjitha këto lojëra ishin të ashpëra, nganjëherë të vrazhda, dhe ishin shpesh të ndaluara. Është i njohur, për shembull, se mbreti Filipi V, në vitin 1319 ndaloi këtë lojë, më vonë Karlo V, 1359 në Francë. Kjo lojë u ndalua edhe nga Edward II në vitin 1314, Edward III në vitin 1349, dhe udhëheqësit tjerë në Angli. Mbreti Edward III, për shembull, ndalon lojën me topin si "një lojë e marrë dhe shkatërruese" ndërsa mbretëresha Elizabeth ndalesën e saj e arsyeton se futbolli

është " lojë e egër dhe mizore që pengon qetësinë javore", dhe se " futbollit në vetvete është një shpikje e djallit " .

Në fillim, më shumë vëmendje i është kushtuar karakteristikave ofansive, ku ishin drejtuar pothuajse të gjithë lojtarët, ndërsa mbrojtjes më pak vëmendje. Sipas të dhënave më të hershme, sistemi i parë i njohur ishte ai që, vijën e parë të sulmit e përbënin nëntë lojtarë (Sistemi 1: 1: 9). Me kalimin e kohës është kuptuar se sulmi i mirë nuk bëhet pa një mbrojtje të mirë. prandaj vëmendja fillon të kushtohet edhe kësaj pjese. Ashtu mbrojtja fillojë të bëhet gjithnjë më e rëndësishme dhe numri i lojtarëve sulmues fillojë të zvoglohet, dhe u rrit numri i lojtarëve mbrojtës. Një ndikim të madh në zhvillimin e mëtejshëm të lojës së futbollit kishin rregullat të cilat në vitin 1862 i hartojë M. Tring.

Në mbledhjen e Federatës së Futbollit të Anglisë, që u mbajt në vitin 1863 në Londër, janë miratuar rregullat e para zyrtare të lojës së futbollit që kishte 13 pikë. Me këto rregulla janë rregulluar çështjet më të rëndësishme të futbollit, si madhësia e fushës, mënyra e marrjes së topit, numri i lojtarëve etj.. Këto dhe ndryshimet e mëvonshme të rregullave përcaktuan përfundimisht fizionomin e lojës së futbollit dhe e ndanë përgjithmonë nga ragbi.

Si ç' do sport tjetër edhe Futbollit si lojë ka kaluar në evolucionin historik të saj duke pësuar ndryshime të mëdha sasiore dhe cilësore në të gjitha komponentët e lojës, rregullat e lojës, ndryshimet infrastrukturore, ndryshimet në metodologjin e stërvitjeve, përgaditjeve psiko-motorike, psiko-sociale, tektoniko-taktike, faktorët morfologjik, ushqimi etj.

Masoviteti i madhë dhe me ndikim të theksuar në jetën shoqërore-ekonomike janë stimuluese të fuqishëm dhe japin motiv të gjithë profesionistëve që në mënyrë profesionale e shkencore të hulumtojnë rreth kësaj loje.

Modernizimi i shoqërisë së sotme kalon edhe nëpërmjet evolucionit, modifikimit dhe ndryshimit të njeriut. Realizimi i formimit të futbollistit të sotëm kërkon një formim edukativ kompleks që vetëm pak vite më parë as nuk mund të mendohej.

Futbollit sipas karakterit të lëvizjeve bën pjesë në grupin e sporteve polistrukturale komplekse. Elementet të cilat demonstrohen gjatë lojës së futbollit përbëhen prej lëvizjeve të ndërlikuara motorike, me lëvizje, vrapime, kthime e kërcime të realizuara në mënyrë dinamike, pra thënë shkurt shkathtësi në ajër dhe veçanarisht në tokë.

Për përparimin dhe arritjen e rezultateve më të mira në lojën e futbollit, duhet njohur edhe faktorët kryesorë, që në mënyrë të drejtëpërdrejtë ndërlidhen apo marrin pjesë në zhvillimin e tij. Disa nga faktorët që duhet njohur për arritjen e rezultateve kulmore janë edhe karakteristikat e futbollistëve, si ato antropometrike, po ashtu edhe motorike.

Futbolli me kalimin e kohës është zhvilluar dhe përsosur shumë, sa që sot kemi një futboll kulminant. Në futbollin bashkëkohor kërkohet nivel i lartë i aftësive, si i atyre tekniko-taktike, psikomotorike, psikologjike-reaguese, po ashtu edhe atyre kondicionale.

Futbolli i sotëm kërkon edhe sistem stërvitor bashkëkohor, si nga sasia, ashtu edhe nga cilësia, duke përdorur të arriturat e fundit nga shkenca.

Kur futbolli i sotëm bashkëkohorë është në shkallen më të lartë të arriturave të tijë, faktori gjenetik, ekonomik, demografik, kulturor, politik etj, janë vetëm disa prej faktorëve që ndikojnë në zhvillimin dhe avancimin e lojës së futbollit.

Qellim kryesor i shkencës sportive është që të ndikojnë në ngritjen aftësive funksionale në nivel sa më të lart, si dhe përzgjedhjes së operatorëve dhe stimulatorët kineziologjik adekuat për ngritjen e aftësive psikomotorike në nivelin e dëshiruar.

Distribuimi i operatorëve kineziologjik si njëri ndër faktorët shumë të rëndësishëm i dëshmuar në ngritjen e aftësive funksionale të sportistit ende deri më sot paraqet në vete një problematikë aq komplekse sa që shpesh ndodh të shfaqen komplikime në mes të harmonisë sistemore kinizeologjike.

Në vitet e fundit në mënyrë të veçantë është shprehur një tendencë për përsheptimin e lojës së futbollit. Një përqindje e madhe e veprimeve të zbatuara me sukses përfundon në një periudhë të shkurtër kohe, me zotërimin e shpejtë të hapësirës dhe me pak kontakte me topin. Sot futbollisti modern ka nevojë për t'iu përgjigjur detyrave në fazën e sulmit dhe të mbrojtjes, dhe për këtë arsye me rëndësi të madhe është që në periudhën përgatitore, aftësitë thelbësore motorike të ngriten në nivelin më të lartë të mundshëm. Për të arritur këtë kërkon një zgjedhje të saktë të metodave dhe mjeteve të trajnimit si dhe nivelin e ngarkesës së duhur. Në këtë mënyrë mund të arrijmë zhvillimin e duhur dhe përmirësimin e aftësive motorike të lojtarëve, të tilla siç janë qëndrueshmëria aerobe dhe anaerobe, shpejtësia, forca, fleksibiliteti dhe kështu me radhë.

Futbolli bashkëkohorë mund të konsiderohet jo vetëm si një ngjarje e madhe sportive, por edhe si fenomeni më kompleks social. Deri te progresi i saj vjen nga rivaliteti reciprok dhe ndikimi i ndërsjelltë i ekipeve të mëdha. Në këto gara, secili ekip tregon fytyrën e saj të vërtetë, duke mobilizuar forcën e lojtarëve të tyre, cilësinë e tyre teknike dhe taktike. Ndeshjet tregojnë se sa e rëndësishme është që të kemi iniciativën në lojë, gjegjësisht në ç' masë një ekip duhet të dominoj, si është i organizuar dhe i përgatitur për ndeshje.

Me këtë punë hulumtuese themi që kemi prekur një fushëveprim të rëndësishëm shkencor e profesional, ku mund të thuhet se edhe në vendin tonë është shumë e nevojshme kultivimi i një sistemi të tillë modern social-shkencor i çështjes së seleksionimit. Problemet e tilla lidhur më statusin psikosomatik që në kuptimin shkencor të lidhen më kuptimin e kineziologjis, ende mbetët për tu hulumtuar e studiuar në përputhje më standardet bashkëkohore shkencore.

2. HULUMTIMET E DERITANISHME

Nga hulumtimet e shumëta dhe të ndryshme të aspektit psikomotorik që janë bërë në vendin tonë dhe më gjerë, kam arritur të veçoj disa nga to, të cilat më kanë shërbyer si udhërrëfyes në këtë punim.

Hughes et al.(1998) vërteton modelet e ekipeve të suksesshme dhe jo të suksesshme në Kampionatin Botëror, 1986 dhe zbulon se ekipet e suksesshme kanë pasur më shumë pasime, kontakte me top se sa ekipet jo të suksesshme. Një studim nga Hughes, është analizuar numri i pasimeve që çoi në shënimin e golave në dy finalet e Kupës së Botës. Dukej se janë shënuar më shumë gola nga sekuencat e gjata të pasimit se sa nga sekuencat e shkurtëra. Posedimi më i gjatë ka rezultuar me më shumë gjuajtje në portë, megjithatë, raporti i golave të shënuara ishte më mirë përmes "lojës së drejtpërdrejtë" në krahasim me "lojën e posedimit". Ekipet e suksesshme shënuan më shpesh nga posedimit i gjatë (në krahasim me atë të shkurtër.

Elsner, B. (1973), ka izoluar disa dimensione morfologjike dhe lëvizore në mostrën e futbollistëve të rangut të dytë federativ dhe republikan të Sllovenisë. Dimensionet e izoluar morfologjike: dimensionin skeletor, dimensionin qarkor i ekstremitetëve të poshtme, dimensionet lëvizore: forca eksplozive, forca izometrike e kofshës dhe e pjesës abdominale, forca izometrike e shtrirjes dhe mbledhjes së gjunjëve, indi dhjamor nënlëkuror.

Analiza e posedimit të topit dhe pasimit në futboll është një fenomen i kohëve të fundit. Jones et al. (2004) ka gjetur se ekipet e suksesshme në Premier League (EPL) kanë në mënyrë të konsiderueshme topin më gjatë në pronësi se ekipet e pasuksesshme pa marrë parasysh rezultatin e ndeshjes. Megjithatë, duhet theksuar se ekipet si të suksesshme ashtu edhe të pasuksesshme kishin kohëzgjatje më të gjatë të posedimit, kur ata ishin duke humbur ndeshjen.

K.Hoxha dhe Z.Cikuli (1995), në studimin e tyre mbi disa të dhëna antropometrike tek fëmijët e Tiranës në moshën 11-14 vjeçare,ku për shqyrtim kanë marrë 16 submostra meshkuj dhe femra

dhe kanë aplikuar një bateri prej 7 instrumentëve matëse për vlerësimin e aftësive primare motorike dhe funksionale.

Për më tepër, Oberstone (2009) ka gjetur se posedimi i përgjithshëm i topit ishte një nga 13 faktorët e rëndësishëm në fushë që dallojnë nga tre nivelet e klubeve EPL (të top katërshit, dymbëdhjetë të mesme, dhe katër të fundit). Në një studim të bazuar në të dhënat e ndeshjeve nga Primera División spanjolle gjatë sezonit 2008-2009, Lago-Peñas dhe Dellal (2010) gjetën, gjithashtu, se ekipet më të suksesshme kanë pasur një përqindje më të lartë të posedimit topit.

Arifi, F. (2003), ka hulumtuar dallimet në hapësirën antropometrike dhe motorikës situacionale të lojës së futbollit në mes futbollistëve dhe nxënësve 13 vjeçarë.

Qëllimi i këtij hulumtimi ka qenë vërtetimi i dallimeve në mes nxënësve futbollistë dhe jofutbollistë, gjë që është vërtetuar me analizë diskriminative, dallimet janë paraqitur sidomos në testet e lëvizjeve situacionale.

Lago-Ballesteros dhe Lago-Peñas (2010) kanë zbuluar se ekipet në pozitat e larta në Primera División të Spanjës patën në pronë në mënyrë të konsiderueshme më shumë topin se ekipet e pozitave të mesme në ligë. Edhe pse posedimi i topi nuk ishte i rëndësishëm për të fituar, apo për të humbur, Lago-Peñas et al. (2010) ka gjetur se skuadrat fituese kishin në mënyrë të konsiderueshme më shumë asistime dhe krosime të kompletuara.

Sokoli, B. (2001) ka hulumtuar hapësirën antropometrike dhe motorike të 98 futbollistëve 13 vjeçarë dhe ka fituar katër faktorë: 2 faktor antropometrik dhe 2 motorik.

Në bazë të këtij hulumtimi studiuesi vjen në përfundim se treguesit antropometrikë, deri diku kanë ndikim të caktuar në parashikim e rezultateve në shumicën e ndryshoreve motorike, andaj parametrat antropometrikë duhet të merren parasysh me rastin e seleksionimit të futbollistëve të rinj.

Gjinolli, E. Sokoli, B. (2000), kanë hulumtuar ndikimin e programit të mësimin të futbollit përmes 8 ndryshoreve të motorikës specifike me anë të dy matjeve (iniciale dhe finale) në mostrën prej 30 studentëve të vitit të dytë të Fakultetit të Kulturës Fizike të Prishtinës, vijues të mësimin të rregullt të lëndës së futbollit.

Qëllimi i hulumtimit ka qenë përcaktimi i ndryshimeve të dimensioneve të motorikës specifike të studentëve të vitit të dytë të FKF-ës, nën ndikimin e programit mësimor të futbollit. Me analizë diskriminative kanonike të hapësirës motorike specifike të lojës së futbollit, janë fituar dallime të rëndësishme mes dy matjeve (matjes së parë dhe të dytë) në favor të matjes së dytë.

Në të dhënat nga Serie A Braziliene, Ames (2011) ka gjetur se për të shënuar gola, posedimi i topi ishte më pak e rëndësishme se përfundimi i pasimeve të vështira. Alamar (2011) ka zbuluar se në Serie A Braziliene pasimet nga mesfusha në zonën sulmuese kanë vlerën më të madhe në drejtim të shtimit të mundësisë së ekipit për të shënuar.

Masar, N., (1982) në punimin “Analiza komparative e karakteristikave trupore dhe aftësive motorike të basketbollistëve të niveleve të ndryshme garuese”, ku për mostër të entiteteve ka marrë tri ekipet e para të Ligës së Dytë Federative dhe tri ekipet e para të Ligës së Parë të Kosovës, në sezonin 1981/82. Pas analizës së të dhënave ka arritur te përfundimi se në shumicën e ndryshoreve relevante nuk ekzistojnë dallime në rangje të ndryshme garuese. Janë vërtetuar dallime vetëm te ndryshoret trupore të basketbollistëve si:

- Masa trupore;
- Gjatësia trupore;
- Perimetri i krahut të shtrirë dhe
- Perimetri maksimal i parakrahut.

Nga dallimet e fituara ka përfunduar se në Ligën e Kosovës seleksionimi ka qenë natyror gjë që ka ndikuar në cilësinë e lojës.

Momiroviq, K. me bashkëpunëtorë (1969) në mostrën prej 4040 të rinjëve dhe të rejave të moshës 12–22 vjeçare aplikuan 40 ndryshore morfologjike, ekstrahuan katër faktorë antropometrikë:

dimensioni longitudinal i njeriut, vëllimi dhe masa e trupit, dimensioni transversal i skeletit dhe indit dhjamor nënlëkuror.

H.Rushiti (1999) në mostrën e 205 të rinjëve të trajtuar me 18 variabla antropometrike dhe 11 motorike me metodën e komponentëve kryesore ka fituar 2 faktorë antropometrik dhe 3 faktorë motorik.me ç'rast ka fituar relacione të rëndësishme të faktorit të gjatësisë dhe testet e forcës eksplozive.

Bahtiri, A., (2001), në mostrën prej 310 individëve, ka hulumtuar lidhshmërinë e hapësirës morfologjike dhe disa ndryshoreve të vrapimit të shpejtësisë, si dhe ka vërtetuar strukturën latente të dy hapësirave. Ka konstatuar se ekziston lidhmëri statistikisht e vlefshme ndërmjet parametrave morfologjikë dhe atyre motorikë, por ajo lidhmëni nuk është e lartë. Ndërkaq, përmes analizës faktoriale ka fituar dy faktorë antropometrikë:

Dimensionaliteti longitudinal dhe transversal dhe masa e trupit dhe

Dimensionaliteti i indit dhjamor nënlëkuror dhe i vëllimit të trupit. Nga hapësira lëvizore ka fituar dy faktorë:

Faktori kompleks i forcës eksplozive, vrapimit të shpejtë dhe agjilitetit dhe faktori i shpejtësisë alternative të gjymtyrëve dhe fleksibilitetit të këmbëve.

Gabrieliç, M. (1972) hulumtoi” Disa aftësi psikomotorike situacionale, potenciale dhe aktuale të rëndësishme për suksesin e fëmijëve në lojën e futbollit”.

Në hulumtim janë aplikuar nëntë teste situacionale me çrast rezultate të hulumtimit kanë vërtetuar se forca eksplozive është e rëndësishme për suksesin e ardhshëm të fëmijëve në futboll. Qëllimi i këtij hulumtimi ka qenë të vërtetohet mundësia e predikcionit të suksesit në lojë në bazë të testeve situacionale që nevojitet për të konstruktuar ose formuluar bateri të instrumenteve matëse për seleksionimin e futbollistëve të rinjë. Rezultatet e hulumtimit kanë treguar nivel të kënaqshëm të predikacionit të suksesit në lojë me ndihmën e testeve të aplikuara.

Statistika e posedimit merr një pjesë të madhe të vëmendjes në lojën moderne. Ekipet kërkojnë për të kontrolluar strukturën dhe ritmin e lojërave përmes posedimit, ashtu siç Barcelona dhe Spanja dominojnë në posedim dhe arrijnë sukses të madh duke bërë kështu. Hulumtimet

akademike mbështesin pikëpamjen se posedimi është çelësi i suksesit në lojën moderne, ekipet që zotërojnë topin më gjatë janë më të suksesshëm. (Bloomfield et al, 2004; Hughes dhe Churchill, 2004, Ridgecell, 2011, Çright et al. 2011, Collet, 2013). Sigurisht sukseesi nuk është i garantuar, dhe në disa kontekste proporcioni i lartë i posedimit ka treguar të jetë një tregues i një ekipi që është duke luajtur baraz ose duke humbur. (Lago dhe Martin, 2007; Lago, 2009; Lago-Penas dhe Dellal, 2010) .

Futbolli është bërë pasion në botë, gjuhën e të cilit të gjithë e kuptojnë dhe në të është i përfshirë një numër i madh i popullatës botërore. Loja është luajtur në çdo kontinent dhe zhvillimi i saj është vazhdimisht në rritje, si në aspektin e cilësisë, atrakcionit, financave dhe disponueshmërisë.

3. QËLLIMI I PUNIMIT

Qëllim kryesor i këtij punimi shkencor e profesional është: Qëllimi i këtij hulumtimi është që të gjendet dhe vërtetohen marrëdhënjet në mes të dhe disa parametrave të lojës siq janë posedimi i topit, pasimeve të bëra gjatë ndeshjesë, pasimeve të sakta të realizuara gjatë ndeshjesë, topave të humbur gjatë ndeshjes, topave të rikuperuar gjatë ndeshjesë, dueleve të fituara, goditjet në drejtim të portës, goditjeve në kornizën e portës si dhe rezultatet e ndeshjeve të zhvilluara.

Ky studim gjithashtu do të tentoj të vërtetoj dallimet të theksueshme në disa parametra të lojës së KF"Ballkani" në dy periudha të ndryshme kohore pra të lojrave ndërkombëtare të KF"Ballkani" të luajtura në vitin 2022 dhe të lojrave të KF"Ballkani" të luajtura në vitin 2023.

Gjithashtu qëllim tjetër në këtë punim është që të gjendet dhe vërtetohen marrëdhënjet në mes të posedimit të topin dhe fitoreve nga të gjitha ndeshjet e analizuara.

Ky studim përcakton nivelin e pregaditjes së ekipit të KF "Ballkani" në periudhën 2022 performancës së treguar gjatë ndeshjeve ndërkombëtare gjatë atij viti si dhe një viti më pas.

3.1 HIPOTEZAT THEMELORE

Duke u bazuar në qëllimin e këtij punimi dhe ndryshorët të cilat do të trajtohen, parashikoj këto hipoteza:

Hipotezat e parashtruara janë si në vijim:

H1. Pritet që nga ndeshjet që ka luajtur KF"Ballkani" në arenën ndërkombëtare në vitet 2022 dhe 2023 në të cilat ka pasur më shumë kohë në posedim të topit ka shënuar fitore.

H2. Pritet që nga të gjitha ndeshjet e zhvilluara të KF"Ballkani" dhe kundërshtarëve të tij në arenën ndërkombëtare në vitet 2022 dhe 2023, ekipet që kanë fituar kanë patur posedim të topit në përqindje më të lartë.

H3. Pritet që nga ndeshjet që ka luajtur KF"Ballkani" në arenën ndërkombëtare në vitet 2022 dhe 2023 në të cilat ekipet që kanë pasur më shumë shuta në kornizë të portës kanë shënuar fitore.

H4. Pritet që nga ndeshjet që ka luajtur KF"Ballkani" në arenën ndërkombëtare në vitin 2023 të ketë treguar performancë më të mirë se sa në ndeshjet e zhvilluara në arenën ndërkombëtare në vitin 2022.

4. METODAT E HULUMTIMIT

4.1 Mostra e entitetit

Për qëllimet e këtij hulumtimi janë marr për analizim 28 ndeshje të KF "Ballkani" të realizuara ndaras me nga 14 ndeshje në të dy vitet ku KF "Ballkani" ka garuara në nivelin ndërkombëtar, pra në ndeshjet e zhvilluara në vitin 2022 dhe në ndeshjet ndërkombëtare të zhvilluara në vitin 2023. Në të dy vitet KF "Ballkani" ka luajtur nga 7 ndeshje në terenin vendor dhe 7 ndeshje të luajtura në terenet jashtë, ndaras për të dyja vitet.

4.2 Variablat që janë aplikuar

Në punim janë përdorur 9 ndryshore specifike:

POSTOP	Përqindja e posedimit të topit
PASTOT	Pasimet në total të realizuara
PASSAK	Pasimet e sakta të realizuara
TOPHUM	Topat e humbur
TOPRKP	Topat e rikuperuar
DUEFIT	Duelet e fituara
SHUPOR	Shutat në drejtim të portës
SHUKOR	Shutat në kornizë të portës
REZULT	Rezultati i ndeshjes

4.3 Mënyra e zbatimit të hulumtimit

Futbolli është një lojë e pasimeve, me lojtar individual që mesatarisht bëjnë më pak se një apo dy prekje të topit. Ndoshta, atëherë, me posedim duhet të quajmë diçka tjetër. Dhe në ndërkohë, duhet të dijmë se posedimi është një statistikë subjektive, dhe reflekton se si ju e shikoni lojën. Çfarë do të thotë kontrollimi i topit në futboll? A është koha e llogaritur se sa është në zotërim të topit një ekip, apo ka lidhje me numrin e pasimeve të topit që realizon një ekip mbrenda ndeshjes? Pra këto janë dy mënyra të matjes dhe llogaritjes së posedimit të topit.

Megjithatë, shpesh ka shumë pak mendime, se si kjo statistikë është llogaritur. A është koha e kaluar që llogaritet në posedim? Nëse po, a llogaritet në posedim kur topi është në ajër? Po në qoftëse ka një pushim apo ndërprerje në lojë? A hyjnë edhe këto në posedim?

Koha e posedimit të topit fillon të llogaritet kur lojtari është në kontakt me topin. Posedimi përfundon kur lojtari e humb topin. Për të minimizuar gabimet njerëzore, shtëpia e të dhënave Opta Sports, i cili jep të dhënat e futbollit për Ligën Premier të Anglisë, përdor një qasje më ndryshe: një metodë algoritmike që nuk ka të bëjë asgjë me kohën.

Analistët e OPTA-s përdorin një softver me video-incizim të drejtpërdrejtë për të gjetur numrin e pasimeve të kompletuara për çdo ekip, duke regjistruar çdo ngjarje të secilit ekip që kanë nga një kod-kohor dhe një koordinatë X-Y . Opta pastaj llogarit zotërim si më poshtë:

Numri i pasimeve të kompletuar nga ekipi A numri total i pasimeve të kompletuar nga të dyja skuadrat.

Për Opta "posedimi i topit" është përqindja e pasimeve të kryera dhe nuk është një masë e kohës, edhe pse Opta pretendon se të dy këto janë të lidhura shumë ngushtë.

Megjithëse ka supozime, referime, shtjellime të ndryshme nga autor dhe hulumtues të ndryshëm si në llogaritje të kohës së posedimit të topit, pasimeve të topit, topave të humbur - të rikuperuar, gjuajtjeve në portë - kornizë, apo edhe të dueleve të fituara apo të humbura, kupola e futbollit Botëror FIFA në faqet zyrtare të saj në internet i shfaq të gjitha statistikatat e mundshme të ndeshjeve zyrtare ndërkombëtare në bazë të përlllogaritjeve tashmë digjitale të shumë veprimeve të ndryshme që ndodhin gjatë një ndeshjeje futbollit. Këto rezultate janë zyrtare dhe janë produkt i hulumtimeve të shumë ekspertëve botëror.

Tabela 1. Rezultatet e 14 ndeshjeve zhvilluara të KF “Ballkani” në arenën ndërkombëtare në vitin 2022

1	CFR Cluj	1:0	Ballkani
% e posedimit	28.08		71.92
2	Ballkani	0:1	Slavia Praha
% e posedimit	46.65		53.35
3	Ballkani	1:2	Sivasspor
% e posedimit	55.31		44.69
4	Sivasspor	3:4	Ballkani
% e posedimit	49.39		50.61
5	Slavia Praha	3:2	Ballkani
% e posedimit	68.84		31.16
6	Ballkani	1:1	CFR Cluj
% e posedimit	66.26		33.74
7	Ballkani	1:0	Shkupi
% e posedimit	67.13		32.87
8	Shkupi	1:2	Ballkani
% e posedimit	54.32		45.68
9	KÍ	2:1	Ballkani
% e posedimit	45.58		54.42
10	Ballkani	3:2	KÍ
% e posedimit	65.23		34.77
11	Ballkani	6:0	La Fiorita
% e posedimit	74.64		25.36
12	La Fiorita	0:4	Ballkani
% e posedimit	30.9		69.1
13	Žalgiris	1:0	Ballkani
% e posedimit	50.76		49.24
14	Ballkani	1:1	Žalgiris
% e posedimit	57.46		42.54

Tabela 2. Rezultatet e 14 ndeshjeve zhvilluara të KF “Ballkani në arenën ndërkombëtare në vitin 2023

1	Dinamo Zagreb	3:0	Ballkani
% e posedimit	53.33		46.67
2	Ballkani Plzeň	0:1	Viktoria
% e posedimit	59.89		40.11
3	Astana	0:0	Ballkani
% e posedimit	38.03		61.97
4	Ballkani	1:2	Astana
% e posedimit	58.26		41.74
5	Ballkani Zagreb	2:0	Dinamo
% e posedimit	45.48		54.52
6	Viktoria Plzeň	1:0	Ballkani
% e posedimit	47.53		52.47
7	BATE	1:0	Ballkani 1:0
% e posedimit	56.55		43.45
8	Ballkani	4:1	BATE
% e posedimit	57.1		42.9
9	Lincoln Red Imps	1:3	Ballkani
% e posedimit	45.43		54.57
10	Ballkani	2:0	Lincoln Red Imps
% e posedimit	66.37		33.63
11	Larne	1:4	Ballkani
% e posedimit	50.49		49.51
12	Ballkani	3:0	Larne
% e posedimit	73.22		26.78
13	Ludogorets	4:0	Ballkani
% e posedimit	40.14		59.86
14	Ballkani	2:0	Ludogorets
% e posedimit	51.68		48.32

5. METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE

Në mënyrë që kërkimi shkencor të jep zgjidhje të kënaqshme, është e nevojshme që të përdoren metodat statistikore të duhura, të drejta dhe komparative e që janë të natyrës së atij problemi të dhënë.

Për qëllimet e këtij hulumtimi janë përzgjedhur metodat statistikore për të cilat konsiderohet se korrespondojnë me natyrën e problemeve që janë hulumtuar.

Për çdo ndryshore të elementeve, janë llogaritur vlerat e mëposhtme:

Parametrat qendrore themelor dhe të shpërndarjes:

- Mesatarja aritmetikore (Ma)
- Devijimi standard (Ds)
- Vlera minimale (Min)
- Vlera maksimale (Max)
- Lakorja e distribucionit ose e shpërndarjes është testuar me anë të koeficientit të asimetrisë ("**skjunis**"), dhe shkalla e lakimit e majës së kurbës ("**kurtozis**").

-Korelacioni sipas Pearsonit

-T-testi

-Analiza regresive

6. INTERPRETIMI I REZULTATEVE

6.1 Analiza deskriptive e ndryshoreve të KF"Ballkani" të vitit 2022 në ndeshjet ndërkombëtare

Në tabelën 3, është paraqitur analiza deskriptive e ndryshoreve: Përqindja e posedimit të topit, pasimet në total të realizuara, pasimet e sakta të realizuara, topat e humbur, topat e rikuperuar, duelet e fituara, shutat në drejtim të portës, shutat në kornizë të portës dhe rezultati i ndeshjes të ndeshjeve në arenën ndërkombëtare të KF "Ballkani" të realizuara në vitin 2022.

Mostra ka përfshirë gjithsej 14 ndeshje të zhvilluara të KF"Ballkani", me ekipe të ndryshme në arenën ndërkombëtare. Në mostrën e përfshir me gjithsej dhjetë ndryshore në tabelën 3, janë të paraqitura vlerat e mesatares aritmetikore, rezultati minimal, rezultati maksimal, devijimi standard, parametrat e shpërndarjes ose të asimetrisë (Skewness – asim, asimetri) dhe shkalla e shtrirjes së kulmit të lakores të distribucionit të rezultateve (Kurtosis – konveksitet).

Nga rezultatet e tabelës 3, shohim se të gjitha ndryshoret kemi një shtrirje të gjerë të rezultateve bazuar në kolonat e rezultati minimal dhe rezultati maksimal. Edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) në të gjitha ndryshoret nuk tregojnë një asimetri të theksuar.

Bazuar në rezultatet e mesatareve aritmetikore kundrejt meseve aritmetike për disa ndryshore të caktuara shohim se kemi të bëjmë me rezultate me shtrirje të gjerë të tyre.

Këto rezultate janë arritur te ndryshoret: pasimet e sakta të realizuara me rezultat të devijimit standard 142.47 kundrejt mesit aritmetik 413.14; shutat në drejtim të portës me rezultat të devijimit standard 6.73 kundrejt mesit aritmetik 12.14; shutat në kornizë të portës me rezultat të devijimit standard 3.07 kundrejt mesit aritmetik 5.28 dhe të ndryshores rezultati i ndeshjes me rezultat të devijimit standard 1.79 kundrejt mesit aritmetik 1.85. Edhe për këto ndryshore, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë një asimetri të theksuar.

Tab. 3 Parametrat themelor statistikor të rezultateve të ndryshoreve të KF"Ballkani" të vitit 2022 në ndeshjet ndërkombëtare.

	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation	Skewness	Kurtosis
	Statistic	Statistic	Statistic	Statistic	Statistic	Statistic	
POSTOP	14	31.16	74.64	57.4864	12.23713	-.511	-.092
PASTOT	14	239.00	691.00	489.9286	141.60262	-.442	-.693
PASSAK	14	156.00	633.00	413.1429	142.47745	-.390	-.604
TOPHUM	14	86.00	172.00	117.1429	27.61509	.981	.445
TOPRKP	14	72.00	138.00	92.0714	20.20078	1.525	1.627
DUEFIT	14	84.00	164.00	106.2143	22.49505	1.466	2.289
SHUPOR	14	4.00	26.00	12.1429	6.73518	1.104	.463
SHUKOR	14	2.00	11.00	5.2857	3.07417	.817	-.271
REZULT	14	.00	6.00	1.8571	1.79131	1.092	.638
Valid N (listwise)	14						

6.2 Analiza deskriptive e ndryshoreve të kundërshtarëve të KF "Ballkani" të vitit 2022 në ndeshjet ndërkombëtare

Në tabelën 4, është paraqitur analiza deskriptive e ndryshoreve: Përqindja e posedimit të topit, pasimet në total të realizuara, pasimet e sakta të realizuara, topat e humbur, topat e rikuperuar, duelet e fituara, shutat në drejtim të portës, shutat në kornizë të portës dhe rezultati i ndeshjes të ndeshjeve në arenën ndërkombëtare të kundërshtarëve të KF "Ballkani" të realizuara në vitin 2022.

Mostra ka përfshirë gjithsej 14 ndeshje të zhvilluara të ekipeve të ndryshme në arenën ndërkombëtare kundër KF "Ballkani". Në mostrën e përfshir me gjithsej dhjetë ndryshore në tabelën 4, janë të paraqitura vlerat e mesatares aritmetikore, rezultati minimal, rezultati maksimal, devijimi standard, parametrat e shpërndarjes ose të asimetrisë (Skewness – asim, asimetri) dhe shkalla e shtrirjes së kulmit të lakores të distribucionit të rezultateve (Kurtosis – konveksitet).

Nga rezultatet e tabelës 4, shohim se të gjitha ndryshoret kemi një shtrirje të gjerë të rezultateve bazuar në kolonat e rezultati minimal dhe rezultati maksimal. Edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) në të gjitha ndryshoret nuk tregojnë një asimetri të theksuar.

Bazuar në rezultatet e mesatareve aritmetikore kundrejt meseve aritmetike për disa ndryshore të caktuara shohim se kemi të bëjmë me rezultate me shtrirje të gjerë të tyre.

Këto rezultate janë arritur te ndryshoret: pasimet në total të realizuara me rezultat të devijimit standard 120.37 kundrejt mesit aritmetik 336.35; pasimet e sakta të realizuara me rezultat të devijimit standard 108.40 kundrejt mesit aritmetik 261.00; shutat në drejtim të portës me rezultat të devijimit standard 7.55 kundrejt mesit aritmetik 13.14; shutat në kornizë të portës me rezultat të devijimit standard 2.84 kundrejt mesit aritmetik 4.50 dhe të ndryshores rezultati i ndeshjes me rezultat të devijimit standard 0.99 kundrejt mesit aritmetik 1.28. Edhe për këto ndryshore, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë një asimetri të theksuar.

Tab. 4 Parametrat themelor statistikor të rezultateve të ndryshoreve të kundërshtarëve të KF "Ballkani" të vitit 2022 në ndeshjet ndërkombëtare.

	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation	Skewness	Kurtosis
	Statistic	Statistic	Statistic	Statistic	Statistic	Statistic	
POSTOP	14	25.36	68.84	42.5136	12.23713	.511	-.092
PASTOT	14	180.00	568.00	336.3571	120.37800	.613	-.421
PASSAK	14	129.00	480.00	261.0000	108.40238	.815	-.046
TOPHUM	14	89.00	164.00	117.3571	21.28057	1.188	1.241
TOPRKP	14	60.00	135.00	88.6429	21.93910	.903	.481
DUEFIT	14	77.00	146.00	101.7857	21.08291	.619	-.428
SHUPOR	14	3.00	25.00	13.1429	7.55347	.227	-1.126
SHUKOR	14	.00	11.00	4.5000	2.84875	.664	.648
REZULT	14	.00	3.00	1.2857	.99449	.425	-.552
Valid N (listwise)	14						

